



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2019:289237

Datë: 21.05.2021

Numri i dokumentit: 01801565

C.nr. 644/2019

GJYKATA THEMELORE GJILAN/DEGA NË VITI - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Arben Xheladini, në çështjen kontestimore të paditësit, NN, e përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore e Republikës së Kosovës, Rr. “Luan Haradinaj” Ndërtesa e ish Rilindjes, kundër të paditurit NN, nga fshati NN, Komuna e Vitisë, me objekt kontesti kthimi i mjeteve, vlera kontestit 82.50 Euro, pas pranimit të përgjigjes në padi, jashtë seance, me datë 11.05.2021, mori këtë:

**A K T G J Y K I M
NË BAZË TË POHIMIT**

I. Detyrohet i padituri NN, nga fshati NN, Komuna e Vitisë, që paditëses NN, t’ia kthejë shumën e të hollave prej 82.50 Euro, në xhirollogarinë e saj, në afat prej 15 ditësh, nga marrja e aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Me datë 10.12.2019, paditësja NN, nëpërmjet Avokatures Shtetërore, ka paraqitur padi, kundër të paditurit Sahit Rexhpi, me të cilën ka kërkuar nga gjykata aprovimin e kërkesëpadiisë dhe detyrimin e të paditurit për t’ia kthyer paditëses shumën e të hollave në shumë prej 82.50 Euro. Pretendimet në padi, i ka mbështetur në faktin se i padituri kishte përfituar nga skema për ndihma sociale, e që në ndërkohë ishte vërtetuar se nuk i ka plotësuar kushtet për këtë ndihmë, dhe për këtë paditësja ia kishte ndërprerë ndihmen sociale të paditurit.

I padituri, në përgjigjen në padi, të dorëzuar në gjykatë me datë 22.02.2020, nuk e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, respektivisht, e ka pohuar kërkesëpadinë duke theksuar se dëshiron që paditëses t’ia kthejë të hollat e kërkuara.

Sipas nenit 148.1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK) “Në qoftë se i padituri deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo tërësisht, gjykata e jep, pa shqyrtim të mëtejshëm, aktgjykimin me të cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesëpadinë (aktgjykimi në bazë të pohimit)”.

Pas vlerësimit të pretendimeve në padi dhe përgjigjes së të paditurit në padi, gjykata konstaton se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për dhënien e aktgjykimit në bazë të pohimit, për shkak se i padituri në përgjigjen në padi e ka pohuar tërësisht kërkesëpadinë e paditëses, ndërsa gjykata nuk ka gjetur se ka pengesa të tjera për dhënien e këtij aktgjykimi respektivisht, gjykata ka gjetur se palët mund të disponojnë lirisht me kërkesat e tyre ashtu siç përcaktohet me nenin 3.1 të LPK, andaj edhe vendosi pa shqyrtim të mëtejshëm si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, Gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 450 të LPK-së.

Nga të lartcekurat, e duke u bazuar në nenin 148 lidhur me nenin 142 dhe 143 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEGA NË VITI
C.nr. 644/2019, datë 21.05.2021

Gjyqtari,

Arben Xheladini

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në Gjykatën Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afatin prej 15 ditëve, pas ditës së pranimit, vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, apo nga shkakut se deklarata e pohimit, është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin e dhunës apo mashtrimit. Ankesa, në kopje të mjaftueshme, dorëzohet në këtë gjykatë.